



NË KËTË NUMËR:

<i>Shumë studentë të rinj pjesë e Kolegjit "Pjetër Budi"</i>	2
<i>Pse duhet të studioni në Kolegjin "Pjetër Budi"?</i>	3
<i>Studime në Doganë dhe Shpedicion – zgjedhje e dubur</i>	4
<i>Studime në Juridik – për profesionistë të suksesshëm</i>	5
<i>Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelerisë – një program unik</i>	6
<i>Administrim Biznesi - për menaxhim të suksesshëm biznesesh</i>	7
<i>dhe të tjera...</i>	

Shumë studentë të rinj pjesë e Kolegjit “Pjetër Budi”

Është duke vazhduar regjistrimi i studentëve të rinj në Kolegjin “Pjetër Budi”. Brucoshët, të cilët kanë zgjedhur të studiojnë në njërin nga drejtimet e ofruara, shprehen se e kanë zgjedhur këtë institucion të arsimit të lartë për shkak të programeve unike dhe punës serioze e të përkushtuar që bëhet me studentët.

Emirë Llapashtica thotë se cilësia e studimeve dhe drejtimet unike kanë bërë që t’i regjistrojë studimet në “Pjetër Budi”. Kurse Elmedina Ramadani thekson se përvoja e studentëve të Kolegjit “Pjetër Budi” e ka shtyrë që edhe ajo të jetë pjesë e tij.



Blend Temaj konsideron se Kolegji “Pjetër Budi” i dha mundësinë që të fillojë së realizuari qëllimin e tij për një karrierë në fushën e turizmit dhe hotelerisë.

Arsyeja e Driton Gjeladinit pse ka zgjedhur të studiojë në “Pjetër Budi” është se ky institucion i vetmi në Kosovë i ka dhënë mundësinë dhe privilegjin të studiojë për doganën dhe shpedicionin, ndërkaq Shukrije Hasani ka zgjedhur “Pjetër Budin” sepse është e bindur se e ardhmja e secilit varet nga fakti se ku studion. “Unë vendosa që e ardhmja ime të jetë e ndritur, unë zgjodha Kolegjin ‘Pjetër Budi’”.



Pse duhet të studioni në Kolegjin “Pjetër Budi”?

Kolegji “Pjetër Budi” është institucioni më prestigjioz akademik në Kosovë e rajon dhe ka për mision organizimin e studimeve universitare sipas standardeve bashëkohore të arsimit të lartë, si dhe kërkimeve shkencore dhe profesionale duke kombinuar teorinë dhe praktikën për pjesëmarrje aktive në ekonominë lokale, regjionale dhe globale. Kjo do t’i kontribuojë zhvillimit të gjithëmbarshtëm në Republikën e Kosovës, por duke përfshirë dhe tërhequr studentë edhe nga rajoni, për të bërë të mundshëm zhvillimin e përbashkët ekonomik, funksionimin e sistemit juridik dhe atij shoqëror në përgjithësi, si parakusht për barazimin me Evropën e zhvilluar Perëndimore.

Në këtë mënyrë, Kolegji “Pjetër Budi” nëpërmjet programeve studimore të veçanta dhe unike, synon të përgatisë kuadro të specializuar për lëmi specifike, të ndërlidhura drejtpërdrejt me praktikën. Kjo bën të mundshme që kuadrot e shkolluar të ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë së vendit dhe të jetë forcë konkurruese me tregun e Bashkimit Evropian.



Studime në Doganë dhe Shpedicion – zgjedhje e duhur

Secili prej jush dëshiron të jetë pjesë e zhvillimeve të avansuara në tregtinë dhe biznesin ndërkombëtar. Nëse keni ambicie për të qenë pjesë e këtyre zhvillimeve ndërkombëtare, ju duhet të pasuroni njohuritë e juaja duke vijuar studimet në programin akademik – shkencor Doganë dhe Shpedicion dhe të merrni një diplomë Bachelor të pranuar në tërë botën. Këtë mundësi ua ofron Kolegji “Pjetër Budi”, i cili është i vetmi në Republikën e Kosovës që ofron programin Doganë dhe Shpedicion.

Nëse bëni zgjedhjen e duhur, ju për një kohë të shkurtër do të mund të punësoheni në Doganën e Kosovës, në institucionet qeveritare ku hartohen politika fiskale-ekonomike, do të mund të filloni dhe menaxhoni bizneset nga fusha e shpedicionit dhe logjistikës vendore dhe ndërkombëtare etj.

Programi Doganë dhe Shpedicion ofron mësim teorik dhe punë praktike profesionale. Pas përfundimit të këtij programi, ju aftësoheni për punë konkrete, pa pasur nevojën për praktikë shtesë. Ju do të fitoni njohuri, shkathtësi dhe kompetencë pune në fushat si: doganë, tregti ndërkombëtar, shpedicion të brendshëm dhe ndërkombëtar, menaxhim të transportit dhe logjistikës etj.





Studime në Juridik – për profesionistë të suksesshëm

Kolegji “Pjetër Budi” tashmë ka krijuar një traditë, duke ofruar programe cilësore dhe deficitare në vend. Një mundësi të mirë për karrierën tuaj ofron programi Juridik. Ky program studimor është dizajnuar të plotësojë nevojat e tregut të ri të punës me kuadër profesionistësh, të cilët do të kenë mundësi që njohuritë e fituara gjatë studimeve t’i implementojë në praktikë dhe procesin e punës.

Programi ofrohet me katër profile të specializuara: Juridik-Penal, Kushtetues-Administrativ, Juridik-Financiar dhe Juridik-Civil. Me kryerjen e njërit nga drejtimet, studenti pajiset dhe specializohet për një lëmi përkatëse nga shkencat juridike.

Programi LLB Juridik në “Pjetër Budi” paraqitet si nismë që të edukojë liderët e rinj akademikë në lëmin e shkencave të drejtësisë. Të diplomuarit nga ky program do të arrijnë një shkallë të avancuar të njohurive, në fushat e tyre të zgjedhura dhe do të fitojnë shkathtësi origjinale akademike dhe shkencore. Programi është i strukturuar nga një përbërje e mirëfilltë interdisiplinare, lëndë të domosdoshme, zgjedhore, punë kërkimore dhe ngritjen e kapaciteteve publike.



Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelerisë – një program unik

Të menaxhosh një institucion a biznes turizmi e hotelerie është ëndërr e shumë të rinjve.

Kolegji “Pjetër Budi” ofron këtë mundësi për të gjithë ata që duan t’i përkushtohen kësaj fushe mjaft atraktive në Kosovë dhe jashtë saj.

Po që se i bashkoheni familjes së madhe të Kolegjit “Pjetër Budi”, në programin akademik Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelerisë, pas tre vjetësh ju do të bëheni profesionist i vërtetë në fushën e turizmit dhe hotelerisë.



Studimet Bachelor në këtë program zgjasin tre vjet, respektivisht gjashtë semestra. Por, ju do të keni mundësinë që në “Pjetër Budi” t’i vazhdoni studimet Master në po të njëjtën fushë.

Tregu i punës në Kosovë, por edhe më gjerë, karakterizohet me mungesë profesionistësh në fushën e turizmit dhe hotelerisë. Ju do ta bëni zgjedhjen e duhur, po që se vendosni të rrugëtoni bashkë me ne.

Lëndët që ligjërohen në programin Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelerisë janë në përputhshmëri me nevojat e tregut dhe në lidhshmëri të ngushtë me politikat integruuese evropiane, me logjikën e tregut të lirë etj.



Administrim Biznesi - për menaxhim të suksesshëm biznesesh

Kush nuk do të dëshironte të administrojë një biznes? Sigurisht se kjo është një ëndërr e shumë të rinjve. Shfrytëzojeni mundësinë që një ëndërr të tillë ta bëni realitet.

Kolegji “Pjetër Budi” ofron nivelin BA të programit akademik Administrim Biznesi, i cili përfshinë katër profile të veçanta: Banka dhe Kontroll Financiar, Menaxhimi i Resurseve Njerëzore, Menaxhimi i Marketingut dhe Administratë Publike.

Nëse bëni zgjedhjen e duhur dhe i bashkoheni familjes sonë, pas tre vjetësh bizneset tuaja do të mund t’i administroni me lehtësi dhe të garantoni se në rrugën e tyre të zhvillimit ato do të jenë biznese të suksesshme.

Me ne ju nuk do arrini vetëm njohuritë e përgjithshme nga fusha e administrimit të bizneseve, por do të specializoheni në fusha më të ngushta të administrimit të biznesit, që do t’ju ndihmojë në karrierën e juaj të mëtutjeshme, akademike dhe profesionale, duke fituar njohuri dhe shkathtësi nga shumë fusha të tjera.

Me fjalë tjera, bashkudhëtimi ynë trevjeçar ofron mundësinë që ju nesër të jeni profesionistë të suksesshëm.



Studioni Sigurime - bëhuni pjesë e industrisë më fitimprurëse



Sigurimet sot janë bërë industri në vete në ekonominë e një vendi. Industria e sigurimeve, së bashku me bankat komerciale janë furnizuesit kryesorë të sistemit financiar në vend. Meqenëse industria e sigurimeve është sektor i ri i krijuar në Kosovë, nevojat për një kuadër profesional nga kjo fushë janë shumë të mëdha.

Shkollimin e kuadrit profesional të kësaj fushe ua mundëson Kolegji “Pjetër Budi”, nëpërmjet këtij program unik, i cili nuk aplikohet nga asnjë institucion tjetër i arsimit të lartë në vend dhe rajon.

Sigurimet janë një element shumë i rëndësishëm në jetën e individit, biznesit dhe zhvillimit ekonomik të një shoqërie dhe një vendi, pasi ato ofrojnë një mbrojtje nga rreziqet që ne nuk mund t’i parashikojmë, por që mund të na ndodhin në çdo çast.

Të gjitha shtresat e shoqërisë kanë nevojë për një sistem të sigurisë, pra, këta mund të jenë klientët e juaj në të ardhmen.

“Pjetër Budi” mundëson arsimimi e kuadrit të nevojshëm në gjitha lëmenjtë e sigurimeve. Me diplomë të sigurimeve, punën e keni të garantuar.



Master në Doganë dhe Shpedicion - i veçantë dhe i vetmi në Kosovë

Secili prej jush që ka përfunduar studimet Bachelor ka pretendime për t'i avansuar njohuritë e tij në një shkallë më të lartë dhe për të marrë përgjegjësi të një udhëheqësi, të një menaxheri në një institucion, në një kompani, në një korporatë etj.

Nëse keni ambicie për të qenë pjesë udhëheqëse e trendeve zhvillimore ndërkombëtare në fushën e Doganës dhe Shpedicionit – që është një fushë shumë e gjerë dhe me interes shtetëror - ju duhet që njohuritë e juaja t'i avansoni, duke krijuar vlera udhëheqëse-menaxheriale, duke studiuar në programin akademik-shkencor Doganë dhe Shpedicion, niveli Master.



Këtë mundësi ua ofron Kolegji “Pjetër Budi”, i cili është i vetmi në Republikën e Kosovës që ofron nivelin Master të këtij programi. Ju për një kohë të shkurtër do të mund të punësoheni në strukturat menaxheriale në Doganën e Kosovës, mund të jeni një udhëheqës i ekipit në nivel qeveritar ku hartohen politika fiskale-ekonomike, mund të menaxhoni një kompani, një korporatë apo një biznes tjetër nga fusha e tregtisë, prodhimit, shpedicionit, logjistikës, transportit vendor dhe ndërkombëtar etj.

Programi Doganë dhe Shpedicion, niveli Master zgjat dy vjet dhe mësimi e hulumtimi shkencor është i shtrirë në katër semestra.

MA në Menaxhment - bëhuni menaxherë të profilizuar



Ky program studimor i përgjigjet në mënyrë optimale nevojave të shoqërisë për kuadro të kualifikuara për zgjidhjen e problemeve për të gjitha nivelet sistemore në vend dhe jashtë.

Me edukimin me këtë program studimor do të plotësohen nevojat për bashkëpunim ndërkombëtar në kuadro institucionale dhe më gjerë.

Programi studimor Menaxhment Master është i dizajnuar që të ofrojë njohuri të thelluara nga lëmi i të gjitha llojeve të menaxhimit. Studentëve u ofrohen për mësim lëndë me karakter menaxherial, lëndë nga menaxhimi financiar, menaxhimi strategjik, marketingu ndërkombëtar etj., si dhe lëndë me karakter profesional. Studentët e diplomuar në këtë program aftësohen për punë në kompani, ndërmarrje apo korporata të ndryshme private vendore dhe ndërkombëtare, fitojnë njohuri për legjislacionin ekonomik, nga menaxhimi i ndërmarrjeve etj.

Ky program prodhon kuadro të profilit, në pajtim me konceptin e arsimimit bashkëkohor, për lidhshmëri të drejtpërdrejtë të teorisë me praktikën. Studentët përfitojnë njohuri dhe shkathtësi për punë në shumë fusha me interes.



MA në Menaxhimin e Turizmit dhe Hotelerisë – vetëm në “Pjetër Budi”

Studimet Master në një fushë atraktive çfarë është Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelerisë ofrohen vetëm në Kolegjin “Pjetër Budi”.

Ky program përgatit kuadro të specializuara për kryerjen e punëve të turizmit dhe hotelerisë, konform nevojave të tregut të punës së Kosovës, si dhe ju përgatit për pozita të larta menaxheriale, me aftësi, shkathtësi dhe kompetenca përkatëse.

Me Master në programin Menaxhimi i Turizmit dhe Hotelerisë, ju prodhoni politika!



Master në Menaxhimin e Sigurimeve – mundësi unike!

Pse është i nevojshëm Masteri në Sigurime? Këtë përgjigje do ta merrni pasi t’i keni përfunduar studimet Bachelor shumë atraktive në Sigurime. Do të ndjeni nevojën për avancim më të lartë dhe më kualitativ.

Industria e sigurimeve është ndër më të zhvilluarat në botë dhe stafi i specializuar në këtë fushë është shumë i limituar. Kjo ju mundëson të jeni ndër më të përzgjedhurit dhe njëkohësisht më të veçantit. Duke përfunduar studimet në këtë program në “Pjetër Budi”, ju mund të jeni të parët, profesionalë dhe me një punësim të sigurt.



K O L L E G J I PJETER BUDI PRISHTINË

KARRIERA JU AJ FILLON KËTU !

KONKURS

Për regjistrimin e studentëve në vitin akademik 2014 - 2015

BACHELOR

- Doganë & Shpeditcion
- Jurifolik
 - E Drejta Penale
 - E Drejta Administrative/Kushtetuese
 - E Drejta Financiare
 - E Drejta Civile
- Menaxhim i Turizmit & Hotelierisë
- Administrim Biznesi
- Menaxhim i Resurseve Njerëzore
- Administratë Publike
- Menaxhim i Marketingut
- Banka – Kontroll Financiar (Polici Financiare)
- Sigurime

MASTER

- Doganë & Shpeditcion
- Menaxhment
- Menaxhim i Sigurimeve
- Menaxhim i Turizmit & Hotelierisë

**Afati i dytë i regjistrimit
prej 20 gushtit deri më 27 shtator 2014**

Marrëveshje me institucione prestigjioze vendore e ndërkombëtare:



Studentët me notë mesatare mbi 9.3 përfshihen në "listën e ngushtë" me rastin e rekrutimit të stafit në Doganën e Kosovës.

APLIKO

Shfrytëzo kushtet e volitshme

Pagesë në 12 këste dhe lehtësira të tjera

ZBRITJE

- Nxënës të shkëlqyeshëm - 10% (BA)
- Grupe deri në 5 veta - 5% (BA & MA)
- Grupe deri në 10 veta - 10% (BA & MA)
- Dy plestarë të një familje - 5% (BA & MA)
- Plestarët e PTK-së - 30% (BA & MA)
- Plestarët e PK-së / Polici Financiare - 30% (BA & MA)
- Plestarët e FSK-së - 20% (BA & MA)
- Dogana e Kosovës/Shpeditcionet - 20% (BA & MA)
- Studentët e Pjeter Budit - deri 10% (MA)

Studime të rregullta universitare

Studime pa shkeputje nga puna

Studime me korrespondencë

Dokumentet e nevojshme për regjistrim

- Diploma e shkollës së mesme
- Dëftesat e secilit vit të shkollës së mesme
- Çertifikata e lindjes
- Fotokopja e letërnjoftimit
- Dy fotografi

Adresa:

Ish objekti i Ombudpersonit përballë Mensës së Studentëve
Ulpianë, Prishtinë
Tel: +381 38 234 566 / +377 44 163 372 / +386 49 163 372
E-mail: pjeterbudi@gmail.com
www.pjeterbudi.com